



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Këshilli i Fakultetit

Ref. nr. 3007

Prishtinë, 8.6.2022

Në bazë të nenit 76 pika 1.8 e Statutit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe Rregullores për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" nr. 1/95 të datës 24.06.2021, Këshilli i Fakultetit në mbledhjen e 37-të të mbajtur më 7.6.2022, mori këtë

V E N D I M

Për formimin e komisionit për shqyrtim të ankesave

I. Formohet komisioni për shqyrtim të ankesave lidhur me konkursin për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime në bazë të nevojave të Fakultetit të Shkencave Matematike Natyrore për vitin akademik 2022/2023. Më propozimin e Dekanit të Fakultetit, komisioni formohet në këtë përbërje:

1. Prof. Dr. Elez Krasniqi, kryetar
2. Prof. Ass. Dr. Liridon Berisha, anëtar
3. Ass. Msc. Manush Mustafa, anëtar

II. Komisioni sipas pikën I të këtij vendimi, është i obliguar që në afat prej 3 ditëve kalendarike pas përfundimit të afatit për paraqitje të ankesave, të shqyrtoj të gjitha ankesat e paraqitura në afatin ligjor dhe të përpiloj raport dhe propozim konkret për Këshillin e Fakultetit. Raporti i hartuar brenda afatit të lart cekur, i nënshkruar dhe protokolluar, dorëzohet në arkivin e Fakultetit për Këshillin e Fakultetit.

III. Komisioni i ankesave mban përgjegjësi ligjore, disiplinore dhe etike për vërtetësinë e përcaktimeve dhe rekomandimeve që bënë në bazë të konkursit për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime në bazë të nevojave të njësive akademike të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" 1/217 të datës 1.6.2022.

IV. Komisioni i ankesave është i obliguar që gjatë punës së tij të respektoj dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë, Ligjit të punës, Statutit të UP-së, Rregullores për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" nr. 1/95 të datës 24.06.2021 dhe Rregullores në fuqi për të ardhurat personale të personelit akademik të UP-së nr. 2/543 dt. 22.10.2021.

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit
- Arkivit të FSHMN-së

Dekani i Fakultetit

Prof. Dr. Idriz Vehapi

